

P. nr.329/2015

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i përgjithshëm, Gjyqtarja **DIANA SINA**, me sekretaren juridike Lamije Kuqi, në çështjen penale kundër të akuzuarit B. A. nga Gjakova, për shkak se ka kryer veprën penale, lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par.1 pika 1.4 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore-Dep.përgjithshëm në Gjakovë, PP.nr.110/2015 të datës 14.05.2015, në shqyrtimin publik gjyqësor, të mbajtur më datën **30.05.2016**, në prani të Prokurorit të shtetit Ismet Tofaj, të akuzuarit me mbrojtësin e tij Av.N. D., të dëmtuarit, me dt.**31.05.2016** mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **B. A.**, i biri i A., e i ëmës N., e gjinisë D., i lindur me ..., në Gjakovë, ku dhe tani banon, me profesion profesor, me kualifikim superior, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar-atë i 3 fëmijëve.

Ë s h t ë f a j t o r:

Sepse: Me dt.02.02.2015, rreth orës 12.30 min. në rrugën “I. Qemajli” në Gjakovë, tek lokali “Belushi”, tjetrit i shkakton lëndim të lehtë trupor me dëmtim të përkohshëm të shëndetit, në atë mënyrë që ditën kritike pas një mosmarrëveshje të mëhershme në mes të dëmtuarit B. B. në njërën anë dhe të akuzuarit B. A. në anën tjetër lidhur me një libër, i njëjti shkon tek lokali i lartë cekur dhe pas një fjalosje e sulmon me shuplakë në fytyrë të dëmtuarin B. B. duke i shkaktuar kështu lëndime të lehta trupore, gjendje kjo e konstatuar nga eksperti mjeko ligjor Dr. F. D. e dt.28.03.2015.

-me çka ka kryer veprën penale, lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par. 1 pika 1.4 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 4,41,46,73, 188 par. 1 pika 1.4 të KPRK-ës, si dhe nenit 365 të KPPK-ës, i shqipton:

DËNIM ME GJOBË:

Me dënim me gjobë në shumë prej **400.-(Katërqind) Euro**, të cilën shumë do ta paguaj në afatin prej 15 ditëve, pasi që Aktgjykimi të merre formë të prerë e nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, Gjykata në bazë të nenit 46 par.3 të KPPK-ës, dënimi me gjobë do ta zëvendësoi me dënim burgu në kohëzgjatje prej **20 (Njëzet) ditësh**, duke llogaritur çdo ditë të qëndrimit në burgim nga **20.-€.(njëzet) euro, të gjobës.**

Detyrohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumë prej **30 Euro**, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

I dëmtuari B. B. nga Gjakova, kompensimin e dëmit mund ta realizon në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, ka ngritë Aktakuzë PP.nr.110/2015 të datës 14.05.2015, kundër të akuzuarit B. A. nga Gjakova, për shkak se ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor , nga neni 188 par. 1 pika 1.4 të KPRK-së, dhe ka propozuar që i akuzuari të shpallet fajtor, të dënohet sipas Ligjit dhe të obligohet në kompensimin e shpenzimeve gjyqësore.

Përfaqësuesi i Prokurorisë Themelore në Gjakovë, Prokurori i çështjes, gjatë shqyrtimit gjyqësor në fjalën përfundimtare deklaroi se, nga dëshmia e mjekut i cili e ka bërë ekzaminimin trupor të dëmtuarit B. B., raporti mjekësor i emergjencës me nr.1169 të dt.02.02.2015, deklaratës së dëshmitarit Sh. V., ku e citoi deklaratën e tij pjesërisht, nuk më kujtohet saktësisht data, por ka qenë paradite ditë e ftoftë, i cili ka dal nga lokalit Belushi për ta ndezur një cigare e aty ka vërejtur B. A. si qytetar të Gjakovës, i cili në një moment e ka goditur me shuplakë fytyrës të dëmtuarin B. B., deklaratës së vet të dëmtuarit se ditën kritike është goditur me dorë nga i akuzuari B., në faqen e djathtë të tij, si dhe deri diku edhe nga deklarata e dëshmitarit N. H., se ditën kritike i akuzuari B. A. ka goditur me shuplakë në fytyrë të dëmtuarin B. B., si dhe vet deklarata e të akuzuarit B. se ditën kritike ka kontaktuar me të dëmtuarin B., konsideroi se janë prova të mjaftueshme se i akuzuari me datë, kohë dhe vend sipas aktakuzës PP.nr.110/15 të dt.14.05.2015, ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor të dëmtuarit B. B., andaj e bëjë përmisimin e dispozitivit të aktakuzës ashtu që në vend të fjalës me grushta dhe shuplaka në fytyrë bëhet me shuplakë në fytyrë të dëmtuarit B. B., duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore, ndërsa pjesa tjetër e aktakuzës mbetet e pa ndryshuar, e gjykatës i propozoi që me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ti ketë parasysh rrethanat lehtësuese, siç janë mos durueshmëria e tij e mëparshme, sjelljet korrekte në gjykatë dhe ndonjë rrethanë rënduese nëse gjën.

I dëmtuari B. B. në fjalën përfundimtare deklaroi, se i bashkëngjitëm ndjekjes penale, por nuk kërkoi kompensimin e dëmit.

Mbrojtësi i të akuzuarit Av. N. D. në fjalën e tij përfundimtare deklaroi, gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor janë proceduar të gjitha provat të propozuar nga Prokuroria si dhe nga mbrojtja e të akuzuarit, dhe në fund e dha mbrojtjen edhe vetë i akuzuari, mbrojtja mendon që duhet ti fal besimi në tërësi mbrojtës së të akuzuarit, pasi që e njëjta ka mbështetje në të gjitha provat tjera, si ato materiale dhe ato të natyrës personale, pra nuk janë vërtetua pretendimet e ngritura nga aktakuza siq pretendon Prokuroria, prokuroria iu referuar disa provave, dëshmisë së dëshmitarit N. H., kinse vërtetojnë pretendimet nga akuza, a në realitet prokuroria interpretoi gabimisht dëshminë e tij, sepse i njëjti asnjëherë nuk ka thënë se e ka parë duke e goditur viktimës, vetëm i referohet dëshmisë sipas dëgjimit të dëshmitarit Sh. V., pra një provë prokuroria në të njëjtën rast tenton që ta përdorë dy herë, dëgjuam edhe dëshminë e viktimës i cili u dëgjua edhe në cilësinë e dëshmitarit, e cila dëshmi nëse krahasohet me provat tjera është shumë e pabesueshme, sepse njëherë qëndron pranë deklaratës që ka dhënë në polici, pastaj për të njëjtin rast në Prokurori, mënyra si është zhvilluar ngjarja-konflikti e shpjegon krejt në mënyrë tjetër, në polici deklaroi se më ka goditur me shuplaka dhe grushta, në prokurori deklaroi se më duket më ka goditur njëherë me shuplak, e këtu deklaroi se më është errësuar pamja, ndërsa në polici që e ka pasur rastin ma të freskët nuk i kujtohet fare që i është errësuar pamja, këtu i thotë se i ka thënë që të vije turp për këtë veprim, por në polici nuk potencon asgjë, kjo dëshmi e dëshmitarit – të dëmtuarit nëse krahasohet me dëshmitaret okular të vendit të ngjarjes, është deklaratë e pa përdorshme, që nuk mund të falet

besimi në asnjë mënyrë, jo vetëm për shkak të objektivitet të përshkrimit të ngjarjes, por janë edhe disa të meta tjera procedurale të kësaj dëshmie, pasi që prokurori paraprak ka qenë dashtë ta propozoi në cilësinë e dëshmitarit në fillim të shqyrtimit, dhe i njëjti nuk e ka propozuar si dëshmitar dhe ka marrë pjesë gjatë gjithë shqyrtimi, ashtu që në këtë drejtim ky deponim i tij nuk mund të jetë provë e pranueshme, është një detal tjetër shumë e rëndësishme me e cekë rreth deponimit të dëshmitarit, ku e ndryshon versionin e goditjes se sa herë është goditur dhe si është goditur, duke u mbështetur në deponimin e dëshmitarit Sh. V. ku ai thotë që e ka goditur njëherë, si dhe në deponimin e ekspertit mjeko ligjor i cili paraqiti një mundësi që lëndimet ka mundur ti merr nga pjesët e brendshme të shuplakës së dorës, këto janë arsytet që të dëmtuarit në cilësinë e dëshmitarit të mos i falet besimi. Ne dëgjuam edhe deponimin e ekspertit për natyrën e lëndimet dhe mundësin se si ka mundur të shkaktohen lëndimet, unë nuk kam vërejtur në pikëpamje teorike se si ka mundur të shkaktohet ai lëndim, eksperti mjeko ligjor vetëm ka fol për supozime me asnjë pjesë të dëshmisë ë tij nuk vërtetohet se i pandehuri B. i ka shkaktuar atë lëndim, ai vetëm shpjegon se natyra e këtij lëndimi mund të shkaktohet me mjete e caktuar dhe me pjesën e caktuar të atyre mjeteve, pra dëshmia e ekspertit e ka lënë të hapur të pa vërtetuar gjendjen faktike, se a ka shkaktuar i akuzuari apo jo, një konstatim jo i plotë i ekspertit mjeko ligjor që për mbrojtjen është shumë më rëndësi sepse eksperti pozoi se mendimin e tij e ka mbështetur vetëm në raportin e repartit të emergjencës, dhe se nga ai raport nuk shifet se është bërë ndonjë ekzaminim shtesë përpos shiqimit fizik që iu ka bërë, prandaj na mendojmë se nuk janë eliminuar dilemat se për shkak të natyrës dhe hasmërisë të atëhershme të palëve ku pala e dëmtuar ka qenë i interesuar për rrjedhën e procedurës dhe me qëllim të hakmarrjes, ekziston mundësia se atë lëndim e ka shkaktuar në mënyra të tjera vet në shenjë hakmarrjes, për shkak të konfliktit që e kanë pas, kemi edhe dëshminë e dëshmitarit Sh. V. ai pohon një fakt se e ka goditur i akuzuari të dëmtuarin, por kemi të bëjmë vetëm me një provë, dhe si e vetme gjykata në pikëpamje formale nuk duhet ti fal besimin sado që do të jetë e besueshme, sepse nëse analizohet pak më detale deponimi i atij dëshmitarit, në kontest të rrethanat të ditës kritike ku ka pas grumbull të njerëzve ka pasur fjalosje në mesë palëve, mund të jetë që ju ka duk që i akuzuari B. e ka goditur të dëmtuarin, është çështje e perceptimit të situatës ku ai e ka perceptua, është edhe në rrethanë më e rëndësishme e natyrës objektive që nuk mund të besohet dëshmime të dëmtuarit, nëse e shiqojm anën fizike të akuzuarit, moshën e tij problemin e tij shëndetësor që i ka dhe në anën e kundërt të viktimës, mundësia e tij fizike, mosha e tij për të mbrojtur dhe sulmuar, dhe është e pabesueshme që ky njeri këtu i pandehuri e ka sulmuar në atë mënyrë, prandaj gjykatës i propozoi që duke pas parasysh të gjitha provat, e paqartësi të tyre, të merr një vendim lirues ndaj të akuzuarit.

I akuzuari B. A. në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se: e mbështetë në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit Av. N. D.

Pas procedimit të provave në shqyrtimin gjyqësor dhe vlerësimit të tyre një nga një, dhe pastaj në lidhje me njëra tjetrën, komfor nenit 361 të KPPK-ës, Gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike, si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, andaj me veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet e veprës penale të lëndimit të lehtë trupor, nga neni 188 par.1 pika 1.4 të KPRK-ës, për të cilën vepër i akuzuari është penalisht përgjegjës dhe është ndëshkuar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, pasi që në rastin konkret nuk ka gjetur asnjë rrethanë e cila kishte për ta përjashtuar përgjegjësin e tij penale.

Këtë gjendje faktike, Gjykata vërtetoi nga deklaratat e të dëmtuarit B. B. dhënë në Stacionin policor në Gjakovë, me dt.02.02.2015, dhe nga deklaratat e tij dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor në cilësinë e dëshmitarit, nga deklaratat e të akuzuarit B. A. dhënë në Stacionin policor me dt.02.02.2015, dhe deklaratat e tij e dhënë gjatë mbrojtjes në shqyrtimin gjyqësor, nga raporti i oficerit lidhur me rastin D. K. me dt.02.02.2015, nga raporti i repartit të emergjencës të lëshuar nga spitali rajonal I. Grezda në Gjakovë, me nr.1169 dt.02.02.2015, sidomos nga akt ekspertimi mjeko ligjor në bazë të dokumenteve të çështjes lëshuar nga eksperti mjeko ligjor Dr. F. D., konstatimi dhe mendimi i tij për natyrën e lëndimeve trupore për të dëmtuarin B. B., të cilat bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore, nga deklaratat e ekspertit mjeko ligjor Dr. F. D. lidhur me sqarimin e ekspertizës së tij dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor, nga deklaratat e dëshmitarëve N. H. dhe Sh. V. dhënë në shqyrtimin gjyqësor, Gjykata gjen se këto prova ofrojnë bazë të mjaftueshme, të njëjtat vërtetojnë se i akuzuari në kohë, vend dhe mënyrë të përshtatshme si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi ka kryer veprën penale me të cilën ngarkohet.

I dëmtuari në cilësinë e dëshmitarit B. B., gjatë dëshmisë së tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor, në pyetjen e prokurorit të çështjes deklaroi, se ditën kritike i akuzuari B. më ka goditur me dorë në faqen time të djathtë, kam ndij një goditje të fortë dhe prej tronditjes më është shfaqur një errësirë, dhe nuk mund ta dija a ka qenë me shuplak apo me grusht, më ka goditur në befasi siç ceka edhe më lartë me dorë dhe për atë moment mua më është errësuar pamja, për disa sekonda por më sa më kujtohet më ka goditur vetëm njëherë, më kujtohet se menjëherë ka ndërhyrë Sh. V., me që rast e ka tërhekur B. nga unë, unë nuk kam reaguar fare në atë moment, përpos me një fjalë që i kam thënë “është turp për këtë çka bëre”. Në pyetjen tjetër të prokurorit, i njëjti deklaroi se kjo mosmarrëveshje ka rrjedh përmes një bisede në rrjetin social në Facebook në mes meje dhe të akuzuarit B., më është kërkuar një libër për të cilën unë nuk kam qenë në ngjarje se për çka bëhet fjalë, më është kërkuar një libër dhe unë i jam përgjigjur se mos më ke ngatërruar me ndonjë person tjetër por unë nuk e kam marrë atë libër, pas dy dite që komunikua në Facebook rastësisht me B. jemi takuar përpara lokalit “Belushi” unë kam qenë duke hyrë në lokal, por para derës akoma pa hyrë në lokal te dera e lokalit jemi takuar dhe aty në fillim më ka thënë “kush je ti që më kundërshton mua” më habiti me sjelljet e tij, sepse kishte një tonë të vrazhdë dhe kërcënues, për kundër kësaj unë ia kam zgjatur dorën që ta përshëndesë, mirëpo ai nuk ma ka zgjatë dorën, dhe menjëherë më ka goditur në fytyrë.

Dëshmitari N. H., gjatë dëshmisë së tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor, në pyetjen e të dëmtuarit B. B. deklaroi, se e kam parë rastin, kam qenë brenda në lokal, ku lokali është me xhama dhe mund të shifet shumë kuart ambianti para lokalit, në atë moment kam vërejt duke ardh B. i cili është takuar me B. dhe për një moment është bërë tollovi dhe kam vërejt që Sh. ka ndërhyrë dhe i ka ndarë, më vonë nga Sh. kam kuptuar që B. e ka goditë B. në vendin e ngjarjes. Në pyetjen e prokurorit të çështjes dëshmitari N. H., deklaroi, se ditën kritike i kam vërejtur që të dytë B. dhe B., kam vërejt që Sh. e ka tërhekur B.. Dëshmitari N. H. në pyetjen e mbrojtësit së të akuzuarit Av. N. D., deklaroi, se nga vendi i ngjarjes kam qenë larg afër 7-8 metra, shton se nuk kam dëgjuar ofendim apo sharje në mes tyre, sepse siq thash më lartë lokali ka qenë me xhama dhe dera ka qenë e mbyllur.

Dëshmitari Sh. V., gjatë dëshmisë së tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor, në pyetjen e të dëmtuarit B. B. deklaroi, nuk më kujtohet saktësisht data e ngjarjes, por e di se ka qenë paradite ka qenë ditë e ftohtë dhe unë kam dalur nga lokali “Belushi” me qëllim që ta ndezi një cigare, posa kam dalur nga lokali kam vërejt B. A. të cilin e kam njohur më parë si qytetarë të Gjakovës, dhe për një moment e ka goditur me shuplakë në fytyrë B. B. të cilin nuk e kam njohur më parë, duke parë këtë situatë unë menjëherë kam ndërhyrë dhe e kam shty B. nga B. duke e kritikuar se është turp se çfarë je duke vepruar, duke e njohur si profesor të muzikës në Gjakovë, shtoi se në atë moment B. B. nuk ka reaguar fare, dhe më kujtohet se është kthyer edhe njëherë B. me qëllim që ta godas B., por unë përsëri kam reaguar, kam ndërhyrë dhe e kam shty B.. Në pyetjen e prokurores së çështjes, dëshmitari Sh. V. deklaroi, se unë kam qenë shumë afër B. dhe B. rreth 30 cm larg prej tyre, dhe siç thash kam reaguar menjëherë, dhe në atë moment nuk kam vërejt se ka qenë dikush mbrapa meje, por brenda në lokal ka pasur mjaftë njerëz, më kujtohet se ka ardh pas meje N. H. me një person tjetër por nuk e di se kush ka qenë, shton se momenti i parë ishte vetëm reagimi i B. kur ka goditur me shuplakë në fytyrë B., më kujtohet që B. ka reaguar dhe i ka thënë “Mos profesor”, B. vetëm njëherë e ka goditur me shuplakë B.. Në pyetjen e mbrojtësit së të akuzuarit Av. N. D., dëshmitari Sh. V. deklaroi, se B. nuk ka pasur asnjë mjetë në dorë.

Eksperti mjeko ligjor Dr. F. D., lidhur me sqarimin e ekspertizës së dhënë lidhur me këtë çështje juridike penale në shqyrtimin gjyqësor, në pyetjen e mbrojtësit së të akuzuarit Av. N. D., deklaroi, se mjeti i fortë nënkuptohet të gjitha ato mjete të cilat kanë konsistencë të fortë me madhësi dhe forma gjeometrike të ndryshme të cilat zakonisht na rrethojnë në jetën e përditshme, mjeti i fortë mund të jetë duke filluar nga trupi i njeriut, boksi, bryli, gjuri, koka, pastaj me mjete të cilat na rrethojnë guri, kocka, tulla etj. fjala besueshmëri nënkupton që dëmtimet e tilla mund të shkaktohen nga mjetet e forta mprehtëse. Eksperti mjeko ligjor Dr. F. D. në pyetjen e prokurorit deklaroi, lëndimet trupore mund të shkaktohen edhe nga boksi siç cekta edhe më lartë, lëndimet trupore mund të shkaktohen edhe me shuplakë kur të goditet me regjionin e gishtit të madh ose mollëzën e shuplakës së dorës, shton se kryesisht ekspertizat mjeko ligjore ashtu edhe në rastin konkret mendimet epen në bazë të raporteve mjekësore të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në rastin konkret jam bazuar në raportin mjekësor e lëshuar nga reparti i emergjencës të spitalit të Gjakovës, me nr.portok.1169 të dt.02.02.2015.

Gjykata i ka vlerësuar dhe analizuar veç e veç të gjitha provat e pastaj duke i ndërlidhur me njëra tjetrën të nxjerra gjatë shqyrtimit gjyqësor, si dëshmia e të dëmtuarit në cilësinë e dëshmitarit B. B., deklarata e dëshmitarit N. H., deklarata e dëshmitarit Sh. V., i cili në mënyrë shumë të kuart dhe bindëse për Gjykatën sqaron se si është zhvilluar ngjarja ditën kritike, i cili ka qenë shumë afër vendi të ngjarjes, gjë që vërtetohet nga dëshmia dëshmitarit N. H. dhe nga deklarata e të dëmtuarit-dëshmitarit B. B., nga deklarata e ekspertit mjeko ligjor Dr. F. D., i cili sqaron në mënyrë të hollësishme ekspertizën e tij në shqyrtimin gjyqësor, se në çfarë mënyre ka mundur i dëmtuari ti merr lëndimet trupore ditën kritike, të cilat dëshmi janë në përputhshmëri të plotë me njëra tjetrën në mënyrën e përshkrimit të ngjarjes, Gjykata gjendjen e tillë faktike e ka vërtetuar sidomos në bazë të akt ekspertimit mjeko ligjor Dr. F. D. për natyrën e lëndimeve trupore të dëmtuarit B. B., që i ka kualifikuar si lëndime të natyrës së lehtë trupore, të cilat lëndime i përgjigjen përshkrimit të ngjarjes nga ana e dëshmitarëve, të dëmtuarit, andaj Gjykata në bazë të këtyre provave të administruara ka konstatuar se me të vërtetë i akuzuari B. A. ditën kritike ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par.1 pika 1.4 të KPRK-ës.

Gjykata i ka vlerësuar dhe analizuar edhe pretendimet e të akuzuarit i cili nuk e pranon fajësinë, por i njëjti nuk mohon faktin se ditën kritike është takuar me të dëmtuarin B. B., me arsyetim se të njëjtin e ka kërcënuar, por nuk ka përdorë forcë fizike atë nuk e ka goditur, arsyetohet se ka qenë shumë i nevrkosu në të dëmtuarin, pasi që sipas tij nuk ia kthyer librin të cilin ia ka huazuar, thekson se është bërë shumë nervoz në momentin kur i dëmtuari në vendin e ngjarjes ia ka zgjatë dorën për ta përshëndetur, gjithashtu nuk mohon faktin se ka ndërhyrë dëshmitari Sh. V. për ta larguar nga i dëmtuari, por arsyetohet se këtë veprim Sh. e ka ndërmarr duke menduar se do ta

godas B., dhe për këtë arsye ai ka ndërhyrë, në bazë të kësaj Gjykata ka konstatuar se pretendimi i tillë i të akuzuarit është i pa bazuar dhe i pa argumentuar në asnjë provë apo dëshmi, por konsideron vetëm përpjekjet e të akuzuarit për ti ikur përgjegjësisë penale, sepse me të gjitha provat e administruara e pastaj të ndërlidhura me njëra tjetrën, e sidomos në bazë të akt ekspertimit mjeko ligjor të Dr.F. D. në emër të dëmtuarit B. B., dhe deklaratës së tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor për mënyrën e lëndimit trupor të marrur ditën kritike i dëmtuari, është vërtetuar gjendje faktike e përshkruar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Gjatë caktimit dhe matjes së dënimit në kuptim të dispozitës së nenit 73 të KPRK-ës, Gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat si ato rënduese, dhe lehtësuese të cilat ndikon në llojin dhe lartësinë e dënimit, pati parasysh peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tij, rrethanat në të cilat është kryer vepra, ndërsa si rrethana lehtësuese muar sjelljet e tij para kryerjes së veprës penale dhe pas kryerjes së saj, mos dënushmërinë e tij të mëparshme, sjelljet korrekt në Gjykatë, të gjitha këto rrethana ndikuan që Gjykata ti zbatoi dispozitat e zbutjes së dënimit të parapara me nenin 73 të KPRK-ës, Gjykata të akuzuarit i shqiptoi dënim me gjobë në shumë prej **400.- (Katërqind)Euro**, të cilën dënim është i detyruar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në dispozitën e nenit 41 të KPRK-ës.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 par.2 të KPPK-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës në emër të akt ekspertimit mjeko ligjor dhe në emër të paushallit gjyqësor është marrë komfor nenit 450 par.1 dhe 2, nën parg.2.1 dhe 2.6 të KPPK-ës.

Nga sa u tha më lart u vendosë si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr.329/15 më datë 31.05.2016**

**Sekretarja juridike,
Lamije Kuqi**

**Gj y q t a r j a
Diana Sina**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej **15 ditësh**, nga dita e marrjes së tij në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj Gjykate.